



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova – Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat ekonomike

Statistikat e Transportit 2025



Prishtinë, 2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada – Government
Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera – Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova – Kosovo Agency of Statistics

Seria 5: Statistikat ekonomike

Statistikat e Transportit 2025



Botues: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK)

Data e botimit: Shkurt, 2026

© Agjencioni i Statistikës së Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qasenë përmes ueb-faqes së ASK-së:

<http://ask.rks-gov.net>

Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur publikimin me të dhëna për transportin rrugor, hekurudhor dhe ajror. Ky publikim statistikor paraqet të dhëna me bazë vjetore, duke përfshirë periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2025, dhe ofron një pasqyrë të qartë të zhvillimeve në secilin modalitet transporti.

Qëllimi kryesor i këtij publikimi është të paraqesë tendencën e zhvillimit të sektorit të transportit dhe ndikimin e tij në ekonominë e vendit. Përmes analizës së të dhënave, përdoruesit mund të vëzhgojnë ndryshimet dhe zhvillimet kryesore që kanë ndodhur gjatë këtyre viteve, duke e bërë më të lehtë planifikimin dhe vendimmarrjen e bazuar në fakte.

Besojmë se ky publikim do të shërbejë si një bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore të ASK-së. Ai ofron informacion të vlefshëm ekonomik dhe të dhëna relevante që mund të përdoren për analiza të sektorit, politika zhvillimore dhe vendimmarrje strategjike në Kosovë.

Propozimet, sugjerimet dhe vërejtjet tuaja mund të dërgoni në adresën zyrtare : infoask@rks-gov.net

Publikimin e përgatitën:

Ilir T. Berisha	- Drejtor i Departamentit të Statistikave Ekonomike
Bekim Bojku	- Udhëheqës i Divizionit Statistikave Ekonomike
Qendresa Shala Sopaj	- Zyrtare për Statistika të Transportit dhe Telekomunikimit
Shqipe Zubaku	- Zyrtare për Statistika të Ndërmarrjeve

Shkurt, 2026

Drejtor Ekzekutiv i ASK-së,

z. Avni Kastrati

Shkurtesat dhe simbolet

- ☐ ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës
- ☐ ANP “Adem Jashari” / LIMAK – Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
- ☐ TRAKOS / TRAINKOS, Sh.A. – Hekurudhat e Kosovës
- ☐ ARC – Agjencia për Regjistrim Civil
- ☐ MI – Ministria e Infrastrukturës
- ☐ km – Kilometër
- ☐ t km – Ton
- ☐ % Përqindje
- ☐ + Rritje krahasuar me periudhën referuese
- ☐ – Rënie krahasuar me periudhën referuese
- ☐ : Mungojnë të dhënat
- ☐ 0 Më pak se gjysma e njësisë së përdorur
- ☐ – Nuk aplikohet
- ☐ km Kilometra
- ☐ t Ton
- ☐ t km Ton-kilometër

Përmbajtja



	Faqe
1. Transporti Ajror.....	8
1.1 Tab.1: Numri i fluturimeve dhe udhëtareve 2015-2025.....	8
1.2 Fig.1: Numri i fluturimeve 2015 - 2025.....	9
1.3 Fig.2: Numri i udhëtarëve 2015 - 2025.....	9
2. Transporti Hekurudhor	10
2.1 Tab: 2: Transporti hekurudhor 2015 –2025.....	10
2.2 Fig: 3. Numri i udhëtarëve dhe sasia e mallrave të bartura përmes transportit hekurudhor 2015-2025.....	11
3. Transporti Rrugor	12
3.1 Mjetet motorike dhe jo motorike të regjistruara	12
3.2 Tab: 3. Mjetet motorike dhe jo motorike të regjistruara 2015-2025.....	12
3.3 Fig: 4. Mjetet motorike dhe jo motorike të regjistruara 2015-2024.....	13
3.4 Rrugët e Kosovës.....	13
3.5 Tab: 4. Gjatësia e rrugëve të Kosovës sipas kategorive në km 2015-2025.....	14
4. Metodologjia dhe përkufizimet.....	16
4.1 Burimet	16
4.2 Mbulimi.....	16
4.3 Përkufizime.....	16

1. Transporti Ajror

Në vitin 2025 gjithsej numri i fluturimeve të realizuara ishte 14,516 apo 11,7 % më shumë së në periudhën e kaluar (viti 2024) ndërsa numri i udhëtareve gjithsej ishte 4 595 524 apo 12,7 % më shumë së në periudhën e kaluar.

Tab. 1: Numri i fluturimeve dhe udhëtareve 2015 - 2025

Përshkrimi Vitet	Numri i fluturimeve të realizuara	Numri i udhëtareve gjithsej
2015	6 334	1 549 138
2016	6 847	1 744 202
2017	7 169	1 885 136
2018	7 921	2 162 474
2019	8 675	2 369 767
2020	4 236	1 102 016
2021	8 397	2 175 959
2022	9 950	2 866 384
2023	11 219	3 420 122
2024	13 001	4 077 482
2025	14 516	4 595 524

Fig. 1: Numri i fluturimeve 2015 - 2025**Fig. 2: Numri i udhëtarëve 2015 – 2025**

2. Transporti Hekurudhor


Në territorin e Kosovës kemi gjithsej 333 km binar hekurudhor për transport. Në hekurudhat e Kosovës qarkullojnë gjithsej 5 lokomotiva Diesel. Lokomotivat bartin 4 vagonë për udhëtarë.

Në vitin 2025, numri i pasagjerëve që kanë shfrytëzuar trenin si mjet udhëtimi është rreth 87 mijë, apo 29% më shumë se në periudhën e kaluar (viti 2024) ndërsa sasia e mallrave të bartura në vitin 2025 nuk kishte.

Tab. 2: Transporti hekurudhor 2015 –2025

Përshkrimi Vitet	Numri i udhëtarëve	Sasia e mallrave të transportuar në neto tonë	Sasia e mallrave të transportuar në neto tonë/km
2015	269 153	736 943	23 217 323
2016	279 205	249 665	7 851 678
2017	156 619	430 859	14 089 436
2018	120 126	479 109	15 371 489
2019	121 056	550 361	23 027 006
2020	58 819	408 225	16 861 862
2021	60 360	553 004	23 465 764
2022	73 331	22 427	2 050 000
2023	70 487	195 670	5 946 548
2024	68 249	2 275	92 426
2025	87 781	0	0

Fig. 3: Numri i udhëtarëve dhe sasia e mallrave të bartura përmes transportit hekurudhor 2015-2025



3. Transporti Rrugor

3.1 Mjetet motorike dhe jo motorike të regjistruara


Në vitin 2025 në Kosovë janë të regjistruara 546 551 mjete motorike dhe jo motorike, në raport me vitin 2024 kemi rritje për 5.34%.

Tab. 3: Mjetet motorike dhe jo motorike të regjistruara 2015-2025

Vitet	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Vetura	281,847	260,291	273,862	280,422	291,295	292,902	322,381	339,131	368,818	411,372	426,708
Automjete transportuese 3.5 t dhe mbi 3.5 t.	18,330	17,963	18,559	33,889	35,153	19,060	21,748	22,310	24,147	27,404	29,127
Automjete transportuese nën 3.5 t.	30,846	31,285	32,299	19,371	19,379	35,705	42,730	46,004	51,265	60,182	67,901
Kombibuset	3,212	2,841	2,535	2,917	2,977	1,768	1,844	1,722	1,680	1,685	1,573
Autobusët	2,124	1,916	1,949	2,326	2,135	1,794	2,091	2,257	2,348	2,616	2,135
Motoçikleta	1,849	1,790	1,690	2,038	2,087	1,694	2,647	1,148	5,379	7,967	9,916
Traktorët	941	613	523	1,791	1,851	641	781	4,289	2,117	2,533	3,500
Rimorkiot nën 3.5 t.	286	288	288	572	681	297	369	443	612	791	1,024
Rimorkiot 3.5 dhe mbi 3.5 t.	2,707	2,628	2,735	305	271	3,101	3,344	3,482	3,739	4,311	4,667
Gjithsej	342,142	319,615	334,440	343,631	355,829	356,962	397,935	420,786	460,105	518,861	546,551

Për vitin 2025, struktura e mjeteve motorike dhe jo motorike të regjistruara dominohet nga veturat, me një përqindje dominuese prej 78.07%. Automjetet transportuese nën 3.5 tonë përbëjnë 12.42%, ndërsa ato mbi 3.5 tonë janë vetëm 5.33% e totalit. Autobusët dhe kombibuset zënë një pjesë të vogël, përkatësisht 0.39% dhe 0.29%, ndërsa motoçikletat përfaqësojnë 1.81%. Traktorët dhe rimorkiot kanë përqindje minimale, me 0.64% për traktorët, 0.19% për rimorkiot nën 3.5 tonë dhe 0.85% për rimorkiot mbi 3.5 tonë.

Fig. 4: Mjetet motorike dhe jo motorike të regjistruara 2015-2025



3.4 Rrugët e Kosovës


Gjatë vitit 2025, gjatësia totale e rrugëve në Kosovë ka shënuar një rritje, duke arritur në 2,463 kilometra, krahasuar me 2,434 kilometra në vitin 2024. Kjo tregon një zgjerim prej 29 kilometra, që korrespondon me një rritje prej 1.19% në infrastrukturën rrugore të vendit.

Tab. 4: Gjatësia e rrugëve të Kosovës sipas kategorive në km 2015-2025

Vitet	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Autoudhë	78.0	98.0	108.0	119.1	137.15	137.15	137.15	137.20	137.20	137.20	137.20
Nacionale	630.4	630.4	630.4	641.7	665.17	753.44	753.44	753	753	753	753
Regjionale	1 305.0	1 305.0	1 305	1313.9	1471.24	1494.93	1494.93	1495	1495	1495	1524
Lidhëse					38.11	46.88	46.88	48.8	48.8	48.8	48.8
Totali	2 013.4	2 033.4	2 043.4	2 074.7	2 311.67	2 432.40	2 432.40	2 434.00	2 434.00	2 434.00	2 463.00

Sipas të dhënave të prezantuara vërehet se në vitin 2025 në territorin e Kosovës kemi 2 463 km, ku në kategorinë e rrugëve auto udhë janë 5 %, nacionale 31 %, ndërsa 62 %, regjionale dhe 2 % janë rrugë lidhëse.


Fig. 5: Struktura e rrugëve të Kosovës sipas kategorive në %



Tab. 5: Rrugët e Kosovës të asfaltuara dhe të pa asfaltuara në kilometra (km)**2015-2025**

Vitet	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Asfaltuar	1 923.4	1 943.4	1 953.4	1 979.3	2 210.67	2 346.86	2 345.86	2 384.26	2 384.26	2 384.26	2 413.30
Pa asfaltuar	90.0	90.0	90	95.4	101	85.54	86.54	49.74	49.74	49.74	49.74
Totali	2 013.4	2 033.4	2 043.4	2 074.7	2 311.67	2 432.40	2 432.40	2 434.00	2 434.00	2 434.00	2 463.04

Nga tabela e mësipërme vërehet se në vitin 2025 nga gjithsejtë 2,434 km rrugë, 2,384 km apo shprehur në përqindje 98 % janë rrugë të asfaltuara, ndërsa 49.74 km apo 2 % e rrugëve janë të pa asfaltuara.

Fig. 6: Struktura e rrugëve të Kosovës sipas kategorive

4. Metodologjia dhe përkufizimet

4.1 Burimet

Statistikat e Transportit dhe Telekomunikimit janë të bazuara në burimet administrative. Burimet e të dhënave janë Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari “ – LIMAC, Hekurudhat e Kosovës TRAINKOS Sh. A, RAILTRANS ShPK ,ARC - Agjencia për Regjistrim Civil (Departamenti për Regjistrimin e Automjeteve të Kosovës) dhe Ministria e Infrastrukturës (Drejtoria për rrugë).

4.2 Mbulimi

Të dhënat me bazë vjetore janë shfrytëzuar për publikim nga viti 2015 deri në vitin 2025 për janë për transportin ajror, hekurudhor dhe rrugor.

4.3 Përkufizime

Rrugë publike - rrugë publike që shërben vetëm për lëvizje të mjeteve motorike, e cila është e shënuar me shenjë të posaçme të trafikut dhe e cila i ka dy shirita rrugorë të ndarë fizikisht për lëvizje nga kahe të kundërta. Shiriti rrugor duhet t'i ketë së paku dy shirita të trafikut me gjerësi së paku 3,5 metra, varësisht nga konfiguracioni i terrenit dhe me nga një shirit për ndalje emergjente në të dy anët e auto udhës, me gjerësi së paku 2,5 metra.

Auto udhë - nënkupton rrugën publike posaçërisht të ndërtuar dhe destinuar vetëm për lëvizjen e mjeteve motorike, e cila është e shënuar me shenjë të posaçme komunikacioni, e cila ka sipërfaqe qarkulluese të ndarë fizikisht për lëvizje nga drejtime të kundërta të shiritave me gjerësi së paku 3,5 metra, varësisht nga konfiguracioni i terrenit, me nga një shirit për ndalje emergjente në të dy anët e autostradës, me gjerësi së paku 2,5 metra.

Rrugë nacionale - nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si rrugë nacionale, e cila lidh dy e më tepër qytete dhe e cilat mund të shërbej si lidhje me rajonet jashtë Kosovës;

Rrugë rajonale - nënkupton rrugën publike e cila lidh qendrat me rëndësi ekonomike të dy apo më tepër regjioneve.

Rrugë lokale - nënkupton rrugën publike zyrtarisht të kategorizuar si një rrugë lokale, që lidh hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të një komune;

Rrugë urbane - nënkuptohet rruga publike që lidh hapësirat e banueshme brenda vendbanimeve të një komune.

Rrugë e pa kategorizuar - nënkupton rrugë e cila nuk është caktuar si rrugë publike, por shfrytëzohet për komunikacion si rruga për shfrytëzimin e pyjeve, rruga e liqeve akumulues, rruga për destinim bujqësor e të ngjashme.

Rrugë lidhëse - rrugë publike e cila lidh vendbanimet me stacionet hekurudhore, rrugët për aeroport, banjë shëruese, qendra rekreative, parqe nacionale dhe të ngjashme.

Tonë-kilometër (tkm) -Njësia e matjes së transportit të mallrave që përfaqëson transportin e një ton të mallrave mbi një distancë prej një kilometri.

Distanca që duhet mbuluar është distanca që aktualisht është udhëtuar në rrjetin e shqyrtuar. Për të shmangur numërimin e dyfishtë, secili vend duhet të llogarisë vetëm t km që kryhet në territorin e saj.

Rreth Agjencisë së Statistikave të Kosovës

Përshkrim i shkurtër

Historiku i shkurtër - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) është institucion profesional dhe i pavarur që merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare statistikore në nivel kombëtar. E themeluar që nga viti 1948, ASK ka kaluar nëpër faza të ndryshme zhvillimore, duke vepruar në përputhje me strukturat shtetërore të kohës.

Pas një ndërprerjeje në periudhën 1989–1999, ASK rifilloi aktivitetin më 2 gusht 1999 si institucion i pavarur brenda Ministrisë së Administratës Publike. Nga 1 korriku 2020 gati për dy vite të plota, veproi në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. Aktualisht funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Financimi i ASK-së bëhet nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga donatorë ndërkombëtarë për projekte specifike dhe ndihmë teknike.

Legjislacioni - ASK vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 për Statistikën Zyrtare dhe ndryshimeve përkatëse përmes Ligjit Nr. 06/L-058. Struktura organizative përfshin Departamente Prodhuese si Departamenti i Statistikave Ekonomike, Departamenti i Llogarive Kombëtare, Departamenti i Statistikave Sociale, Departamenti i Statistikave të Bujqësisë e Mjedisit, Departamentet mbështetëse si Departamenti i Metodologjisë dhe Teknologjisë Informative, Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim, Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit, Departamenti i Administratës. Në kuadër të Agjencisë veprojnë edhe Zyrat Rajonale në: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj dhe Mitrovicë.

Misioni i ASK-së - Të ofrojë të dhëna statistikore cilësore dhe të besueshme për të gjithë përdoruesit – institucione qeveritare, komunitetin akademik, sektorin privat dhe publikun e gjerë – në mbështetje të vendimmarrjes, planifikimit dhe zhvillimit të politikave në të gjitha nivelet.

Objekti i ASK-së - Të prodhohen dhe shpërndahen të dhënat statistikore në mënyrë sistematike, të besueshme dhe të paanshme. Përfshirë shfrytëzimin profesional dhe standardet etike, d.m.th se politikat dhe praktikrat janë transparente për shfrytëzuesit dhe respondentët e anketave.

Vizioni i ASK-së - Të jetë burimi kryesor dhe më i besueshëm i statistikave zyrtare në Kosovë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke mbështetur vendimmarrjen, transparencën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Bashkëpunimet - Agjencia e Statistikave të Kosovës bashkëpunon me të gjitha Ministritë e Qeverisë së Kosovës sidomos me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe Bankën Qendrore të Kosovës ku edhe përbejnë Sistemin Statistikor të Kosovës. Agjencia ka bashkëpunim të ngushtë edhe me organizata ndërkombëtare si: EUROSTAT, FMN, Banka Botërore, INSTAT, SIDA, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, VIIES, IMF, ILO STAT, UNODC, ETF, IA, OECD si dhe me institucionet statistikore të rajonit.

Gjatë vitit 2024, u realizua me sukses Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë – një projekt kyç për hartimin e politikave zhvillimore të qëndrueshme.

ASK mbulon tërë territorin e Republikës së Kosovës përmes rrjetit të njësive raportuese dhe qarqeve statistikore, duke siguruar të dhëna të dorës së parë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Adresa:

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë

Telefoni:

+383 (0) 38 200 31 129

Drejtori Ekzekutiv:

+383 (0) 38 200 31 112

Fax:

+383 (0) 38 235 033

E-mail:

infoask@rks-gov.net

Ueb-faqe:

<http://ask.rks-gov.net>